



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:169346

Datë: 31.01.2020

Numri i dokumentit: 00799901

P.nr. 1019/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati , me Praktikanten A. H, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.B nga Prizreni rr.”...” nr...., për shkak të veprës heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1314-14/19, të datës 06.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Shahadin Destani, dhe i akuzuari, me datë 29.01.2020, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.B, nga i ati R. dhe e ëma R., e lindur U. , i lindur me datën ... në Prizren, ku edhe jeton në rr.”...” nr...., i martuar, baba i ... fëmijve, me profesion doktor gjinekolog, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., turk, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Se me datë 26.06.2019 rreth orës 12:00 minuta, në Prizren, në rrugën “..”, saktësisht në ordinancën gjinekologjike “...”, heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të lokalit dhe hyn në lokalin e siguruar, në atë menyrë që pasi Inspektoriati Sanitar pranë KK Prizren, me datë 14.05.2019 kishte kryer kontrollimin e rregullt në ordinancën në fjalë dhe kishte konstatuar me procesverbalparregullësi duke i ndaluar ushtrimin e veprimtarisë shërbyese – mjekësore deri në eliminimin e të metave të konstatuara në procesverbal dhe në aktvendimin me nr.... të datës 15.05.2019, i pandehuri heqë, dëmton shenjën zyrtare nga Drejtoria e Inspektoriateve – inspektoriati sanitar, hap lokalin dhe fillon të punojë, me ç’rast gjatë kontrollit me datë 26.06.2019 ende pa u eliminuar të metat e cekura sikurse në procesverbal dhe aktvendim, haset nga inspektorët duke ushtruar veprimtarinë shërbyese – mjekësore.

Këso dore ka kryer veprën penale heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 40, 43, nenit 406 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBE

Në lartësi prej **500€ (pesëqind)**, te cilën shume i akuzuari është i obliguar që ta paguaj ne tre keste mujore duke filluar prej seciles kest nga qdo fillimi i muajit 01.-05. te muajit vijues ne afat prej 15 diteve nga plotfuqishmria e ketij Aktgjykimi. Nese i akuzuari denimin me gjobe nuk deshiron apo nuk mund ta paguaj, nuk mund te ekzekutohet as me detyrim, i njejt do te zevedesohet me denim burgu duke llogaritur per qdo 20 € 1 (nje) dite burg, respektivisht 25 dite burgim.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, në emër të komepenzimit të viktimave të krimit shumën prej 30 Euro. Te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1314-14/19, të datës 06.08.2019, kundër të akuzuarit **G.B** Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar në prezencën e paleve pasi që u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të shtetit, Gjykata shpalosi dhe bëri prezentimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari deklaroi se nuk i kundërshton provat me të cilat mbështetet aktakuza, andaj edhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet deklaroi se është hera e parë dhe pa qellim të, duke theksuar faktin se e ka respektuar procesverbalin e kontrollimit inspektues të inspektorëve dhe nuk e ka ditur se ka bërë heqjen e shenjës së ngjitur nga inspektorët pasi e ka rregulluar lokalin brenda, premton se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, andaj e lut gjykatën që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë sa i përket veprës penale e ka bërë vullnetarisht, që është në pajtim me nenin 248 të KPP-së.

Gjykata vleron se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësive, pranimi i fajësive është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, nuk ka qenë i detyruar ose i shtrenguar në asnjë mënyrë që tapranoj fajësine.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datë 26.06.2019 rreth orës 12:00 minuta, në Prizren, në rrugën "...", saktësisht në ordinancën gjinekologjike "...", heq ose dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të lokalit dhe hyn në lokalin e siguruar, në atë menyrë që pasi Inspektoriat Sanitar pranë KK Prizren, me datë 14.05.2019 kishte kryer kontrollimin e rregullt në ordinancën në fjalë dhe kishte konstatuar me procesverbalparregullësi duke i ndaluar ushtrimin e veprimtarisë shërbyese – mjekësore deri në eliminimin e të metave të konstatuara në procesverbal dhe në aktvendimin me nr.17-530-192 të datës 15.05.2019, i pandehuri heqë, dëmton shenjën zyrtare nga Drejtoria e Inspektoriateve – inspektoriat sanitar, hap lokalin dhe fillon të punojë, me ç'rast gjatë kontrollit me datë 26.06.2019 ende pa u eliminuar të metat e cekura sikurse në procesverbal dhe aktvendim, haset nga inspektorët duke ushtruar veprimtarinë shërbyese – mjekësore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar fajin, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo demtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoi dënimin me gjobë, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 70 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk ka gjetur rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pendimi i thell, është doktorr, pensionist, është hera e parë dhe e pa qëllim, premtori se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla kundërligjore. Andaj Gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450. dhe 453. par. 1. të KPP-se.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit u mar në kuptim të nenit 39.par.3. pika 1. të Ligjit me nr. 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:169346, 29.01.2020

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.